

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E SUPERINTENDENTIT

440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301

PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

WILLIAM R. HITE, JR., Ed.D.
SUPERINTENDENT

24 PRILL, 2017

I dashur prind/kujdestar:

Në javët e fundit, një grup i madh nxënësish janë grumbulluar pas mësimit në qënder të qytetit dhe afër zonave të nyjeve të transportit duke çuar në sjellje të parregullta dhe incidente të shumta. Për sigurinë e fëmijes suaj dhe të të tjerëve, Drejtoria Arsimore, Policia e Filadelfias dhe e SEPTAs ju inkurajojnë që të diskutoni me fëmijën tuaj për rrezikun e kësaj vërdallisje të pakuptimtë në grupe të mëdha dhe pa ndonjë pikësynim të caktuar.

Ndërsa ky numër nxënësish të përfshirë në një aktivitet të parregullt dhe kriminal përbejnë një përqindje të vogël të nxënësve tanë, kjo po krijon një portret negativ të të gjithë adoleshenteve në qytet. Disa nxënës janë arrestuar për sjellje shqetësuese të prishjes së rendit publik, dhe të tjerë nxënës janë dëmtuar fizikisht.

Policia e drejtorisë arsimore kërkon nga nxënësit të sillen mirë dhe të jenë të respektueshem kur ecin për ne shkollë ose dalin nga shkolla, si edhe kur përdorin transportin publik. Ju lutemi, jini të vëmendshëm se kur fëmija juaj përdor biletën e transportit, dhe kur ai sillet në mënyrë të parregullt, do të rezultojë në humbjen e privilegjit të udhëtimit falas me mjetet e SEPTAs. Nëse ndodh kjo, prindërit duhet të paguajnë për transportin e fëmijes tyre shtëpi shkollë. Nxënësit që e humbasin passin për transportim, do të duhet të ndjekin shkollën çdo ditë dhe në orar. Kodi i Sjelljes së Nxënësish është njësoj për të gjithë nxënësit pa përjashtim, edhe për ata që përdorin çdo lloj mjet transporti. Nxënësit që e shkelin këtë Kod do të kenë pasojë disiplinuese shtesë.

Ne kerkojmë nga ju të theksoni me fëmijën tuaj se sa e rëndësishme është paraqitja e vetes së tyre dhe komunitetit të shkollës pozitivisht në çdo kohë. Ne theksojmë që nxënësit të shmangin aktivitete të rrezikshme.

Ndërsa moti vjen duke u ngrohur, policia do të jetë me e pranishme në qënder të qytetit dhe në mbarë qytetin, për të siguruar jetën e nxënësve dhe të të tjerëve. Ne deshirojmë, që qytetarët dhe vizitorët në qytet, të shohin me të mirën tek nxënësit tanë në çdo kohë, si brënda dhe jashtë shkolle. Ju lutemi na ndihmoni që kjo të realizohet.

Ju faleminderit paraprakisht për ndihmën dhe mbështetjen tuaj

Sinqerisht,



William R. Hite, Jr., Ed.D.